

Fëmijët shqiptarë, të ftuar në eventin evropian të aftësive digjitale në Bukuresht

Një ekip inovatorësh të rinj të moshave 15 deri në 18 vjeç të shkollës “**Matosh Uka**” në **Tropojë** ishin të ftuar në Bukuresht javën e kaluar, për të festuar arritjet e tyre në sfidën *Vodafone Foundation Skills Upload Jr (SUJ) Challenge 2025*. Ky event u mbajt për të nderuar fituesit e sfidave kombëtare në aftësitë digjitale dhe teknologjike, duke krijuar kështu në platformë për të shpërfaqur kreativitetin dhe shpikjet e këtyre të rinjve në skenën ndërkombëtare.

Të rinjtë shqiptarë u ftuan si fituesit e Hakathonit Kombëtar, *Skills Upload Junior*, zhvilluar në veri të Shqipërisë, duke iu bashkuar bashkëmohatarëve nga vende të tjera si Gjermania, Greqia, Italia, Portugalia, Spanja, Rumania dhe Turqia. Gjatë këtij eventit, të rinjtë ndanë përvojat e tyre, shkëmbyen njohuri mes njëri-tjetrit dhe ndërtuan miqësi që do të zgjasin gjatë gjithë jetës. Aftësitë e tyre digjitale luajnë një rol kyç në ndërtimin e urave kulturore, gjinore dhe luftojnë ndasinë midis brazave, duke dëshmuar edhe një herë tjetër për fuqinë e teknologjisë për të ndërlidhur njerëzit.

Skills Upload Junior Challenge është pjesë e programit me të njëjtin emër të Fondacionit Vodafone që ka zgjatur nga nëntori i 2024-ës deri në shkurt të 2025-ës dhe gjatë të cilit mijëra të rinj e fëmijë të moshave midis 6 dhe 19 vjeç krijuan zgjidhje inovative për çështje të ndryshme sociale të komunitetit, fokusuar kryesisht të Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm, gjithëpërfshirja dhe aftësitë digjitale.

Ekipi shqiptar përbëhej nga katër fëmijë nga Tropoja, të cilët zhvilluan një sistem të automatizuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, duke mos lejuar që ato të përfundonin në liqenin e Komanit dhe Fierzës përmes lumit të Valbonës, duke përdorur sensorë dhe lëvizje të programuara që garantojnë efikasitet.

Ide të tjera fituese në sfidën kombëtare ishin edhe projektet që përdorin Inteligjencën Artificiale për të identifikuar dhe grumbulluar me saktësi mbetjet, sistemet e automatizuara që i japin zgjidhje trafikut të rënduar në afërsi të shkollave dhe teknologjia që “neutralizon” intervistat e punës, duke eliminuar qëndrimet e njëanshme në procesin e rekrutimit për vendet e punës.

“Ndikimi pozitiv në jetët e kaq shumë të rinjve është një arritje për të cilën jemi shumë krenarë dhe një dëshmi e angazhimit të Fondacionit Vodafone për të nxitur gjithëpërfshirjen përmes edukimit digjital”, u shpreh Joakim Reiter, Drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë në Grupin Vodafone, i cili shtoi gjithashtu se “Mbetet ende shumë për t’u bërë, ndaj ne do të vazhdojmë të punojmë fort me partnerët tanë në të gjithë Evropën për t’u siguruar që sa më shumë fëmijë dhe të rinj të kenë akses jetik në aftësitë digjitale, të cilat janë jetike për të ardhmen e tyre. Kështu thellojmë njohuritë digjitale dhe se si ato mund të përdoren në mënyrë të sigurtë e të përgjegjshme për të ndihmuar të rinjtë dhe fëmijët që të navigojnë të sigurtë dhe me vetëbesim botën digjitale.”

Programi *Skills Upload Junior* ndihmon fëmijët dhe të rinjtë në gjithë Evropën të fitojnë aftësi digjitale dhe të krijojnë vetëbesimin që iu duhet në jetë. Pavarësisht se kush janë dhe nga vijnë, ky program i ndihmon të rinjtë të ndjehen të sigurtë dhe fuqizuar gjatë përdorimit të mjeteve digjitale. Kjo arrihet duke iu bashkuar atyre në laboratorët digjitale të dedikuara, në shkollat e tyre apo duke i përfshirë këta të rinj në projekte të ndryshme, të dizajnuara për të nxitur mendimin kritik dhe kreativitetin.

Programi *Skills Upload Junior* ofron gjithashtu trajnime e mjete teknologjike për mësuesit dhe të rinjtë, duke u siguruar që aftësitë digjitale të aplikohen në të gjithë kurrikulën, jo vetëm në orën e IT-së apo lëndët shkencore.

Përveçse rritjen e aftësive digjitale në vend, Fondacioni Vodafone Albania po i ndihmon të rinjtë shqiptarë të ndërtojnë gjithashtu edhe një komponent ndërkombëtar, duke bërë kështu atë që Vodafone bën më mirë: **TË NDËRLIDHË!**